

## Procesverbal

Sot me datë 14.11.2017, ora 16:30 u mbajt një dëgjese publike në ambientet e Bibliotekës nr. 10, Njësia Administrative nr. 4 me tematikë “Buxheti për vitin 2018 për Njësinë Administrative nr. 3 dhe Njësinë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë.” Në këtë takim ishin të pranishëm Administratori i Njesisë nr. 3 znj. Ergesta Ninga, Administratori i Njesisë nr. 4 znj. Liri Qoshi dhe gjithashtu i pranishëm ishte dhe z. Erindi Bejko, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative si dhe Emergjencave Civile, ndërlidhësit me komunitetin si edhe qytetarë nga të dyja këto njësi.

Programi i këtij takimi:

**Znj. Liri Qoshi**, Administratore e Njesisë nr. 4, pasi falenderoi pjesëmarrësit theksoi se qëllimi i kësaj dëgjese, tashmë e kthyer në një praktikë pune të përvitshme të Bashkisë Tiranë, e cila sigurisht që duhet përshëndetur, është jo vetëm diskutimi në komunitet i projekt buxhetit, por edhe dhënia e mendimeve dhe sygjërimeve të qytetarëve për t'i çuar investimet aty ku kanë më shumë impakt dhe janë më shumë të nevojshme në njësitë tona.

Më pas administratorja znj. Qoshi bëri një pasqyrë të shkurtër të investimeve të kryera gjatë këtyre dy viteve të gjysëm nga Bashkia Tiranë, duke falenderuar Kryetarin e Bashkisë z. Erion Veliaj për vëmendjen e madhe që i ka kushtuar kësaj njësie, deri dhe të lënë në harresë.

1. Rikonstruksioni total i kopshtit nr. 25 dhe 55. (Investim i Bashkisë Tiranë dhe premtime të mbajtura nga Kryetari)
2. Ndërtimi i shkollës së re “Ardian Klosi”
3. Përfundimi i Qendrës së re Multifunkcionale
4. Rehabilitimi i bregut të lumit (Rehabilitim i shtratit të tij, fortifikimi i banesave afër lumit dhe zgjidhja përfundimtare e riskut të Emergjencave Civile në këtë njësi administrative).
5. Rikonstrukcioni i rrugëve “Shefqet Kuka”, Rexhep Tarja”, “Imer Ndregjoni” “Kahreman Ylli”, “Selaudin Bekteshi”
6. Rehabilitimi i bllokut të Alliasit (28 rrugë të përfunduara, deri dhe të paurbanizuara)
7. Rehabilitimi i bllokut të banimit 6.1 që kufizohet nga rruga “Njazi Meka”, rruga e Dibrës, rruga “Niko Avrami”, rruga “Grigor Perleçev” etj. (Me 16 rrugë dhe 3 kënde rekreative )
8. Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në rr. e Dibrës dhe drejt përfundimit rruga e Dibrës.

**Znj. Ergesta Ninga**, Administratore e Njesisë Administrative Nr.3 merr fjalën duke falenderuar Bashkinë e Tiranës për të gjitha investimet e kryera gjatë 2 viteve në gjithë territorin e Njesisë Administrative Nr.3 dhe të gjithë të pranishmit në këtë takim. Vëmë në vëmendje investimet e realizuara, përgjatë dy viteve në Njësinë Administrative Nr.3:

1. Rikualifikimi i rrugëve “Arkitekt Kasemi” dhe “Sitki Çiço”
2. Rruga e Dishëve, e cila ndodhet në zonën e Kodrës së Priftit është në përfundim
3. Rruga “Kujtim Laro” i është nënshtruar një rikonstruksioni të plotë me trotuare, vijëzime dhe kanalizime të ujrave të zeza
4. Asfaltim i plotë i rrugës “Arkitekt Sinani” dhe kanalizim i ujrave të zeza
5. Rikualifikim i blloqeve të banimit tek rruga “Bardhyl”

6. Ish tregu i fruta perimeve tashmë është kthyer në një lulishte funksionale për banorët tek zona e Varrit të Bamit
7. Sistemimi i rrjetit të kanalizimeve tek pall. nr. 69 në rrugën “Kongresi Manastirit”
8. Rikualifimi i shtratit të lumit të Lanës
9. Riparim i trotuarëve tek Kodra e Prifit dhe në rrugën “Dalip Topi”
10. Rikonstruksioni i kopshteve nr. 20, nr. 22 dhe nr. 60, gjithashtu edhe çerdheve nr. 15, 56 dhe 26 në kuadër të nismës “Adopto një çerdhe/kopësht”
11. Inagurimi i shkollës për fëmijët me nevoja të veçanta “Luigj Gurakuqi”
12. Ndërtimi i këndit të lojrave në zonën e Brrylit
13. Gjelbërimi dhe mbjellja e pemëve në fund të bulevardit “Zhan D’ark”

Falenderimi gjithashtu shkon edhe për Agjensinë e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtorisë Nr.2 një ndriçim të plotë në shumicën e rrugëve që shtrihen në territorin e Njesisë Administrative Nr.3.

**Z. Erindi Bejko**, drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative si dhe Emergjenave Civile

Bashkë me falenderimet për pjesmarrjen fillimisht z. Bejko përmend rëndësinë e këtyre dëgjesave publike për të kuptuar nevojat reale dhe vlefshmërinë e investimeve që janë kryer. Z. Bejko gjithashtu përmendi investimet e mëdha që janë bërë nga Bashkia Tiranë si:

- Rikonstruksioni i Sheshit Skënderbej
- Pazari i Ri
- Parku Olimpik
- Zgjatimi i Bulevardit etj

Për të vazhduar të realizojmë punë në të mirë të komunitetit, duhet që të menaxhojmë në mënyrë sa më efektive buxhetin, brenda mundësive që kemi. Duke vazhduar me investime konkrete

Nevojat e Njesisë Administrative Nr. 3:

1. Rikonstruksioni i rrugës “Naum Veqilharxhi”
2. Rikualifikimi i zonës ku shtrihet rruga “Dum Alla”
3. Rikonstruksioni total i shkollës 9-vjeçare “Xhezmi Delli”
4. Ndërtimi i një shtese tek shkolla e mesme “Andon Zako Çajupi”
5. Rikualifikimi i zonës tek Kodra e Prifit

Ndërsa për Njësinë Administrative nr. 4 nga z. Erindi Bejko u përmendën këto investime për vitin 2018.

1. Pritet të fillojë shumë shpejt blloku nr. 92 92/1 që kufizohet nga rrugët “Hava Murati”, “Çelo Sinani”, “Çelo Ibraj”, “Vath Kokalari”, “Halit Bega”, “Tasim Shehu”, “Xhafer Zelka” , “Skënder Vila”, Lumi i Tiranës. Projekti është në fazë tenderimi i cili ka qenë prioriteti i propozuar nga Njësia Administrative nr. 4
2. Rruga e Dibrës: Aktualisht vazhdojnë punimet dhe me një vëmendje të veçantë korsisë së biçikletave jo vetëm në këtë njësi por në gjithë Tiranën si dhe do rishikohet mundësia për zgjatimin e këtij projekti deri në Kiunostudio, e cila do të rivitalizojë të gjithë zonën duke qenë se është dhe zonë me trashëgimi kulturore.

3. Rikonstrukcioni i shkollës “Ramazan Jarani” në rrugën “Andrea Mano” . z. Erindi permendi se Bashkia e Tiranës ka një vëmendje të veçantë për shkollat në heqjen e turneve të dyta të mësimdhënies jo vetëm për këtë shkollë, por dhe për gjithë shkollat e tjera në gjithë Tiranën.
4. Rehabilitimi i bllokut të banimit 93 i cili kufizohet nga rr. “Aleksandër Moisiu”, “Myslym Keta”, “Pjetër Dungu” me infrastrukturën e nevojshme KUZ, KUB, ndriçim, vende të dpozitimit të mbetjeve urbane.
5. Rikonstrukcioni i rrugës “Selaudin Zorba” dhe prioritet i rradhës është asfaltimi i rrugicave të mbetura nga blloku Allias, projekt i cili do te finalizojë në 2018 gjithë bllokun Allias.

**Z. Erindi Bejko** u shpreh se për Njësinë Administrative nr.3 dhe Njësinë Administrative nr.4 është parashikuar një buxhet prej 500.000.000 lekë të reja.

Diskutimet vazhduan në formë bashkëbisedimi midis qytetare si dhe përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë ku problematikat kryesore kishin të bënin me mungesën e stolave në sheshe rekreative, probleme me ndriçimet, me kanalizimet, rrugica të paasfaltuara ose të dëmtuara etj.

**Z. Gani Shehu:** (Njësia Administrative nr. 4) Kemi problem me dy rrugica të pashtuara në zonën Allias. Rruga “Aglahi Tako” dhe “Zef Bumçi”. Shpresojmë marrjen në konsideratë edhe të peticioneve tona.

**Znj. Liri Qoshi:** Këto dy rrugë që përmendët për të cilat ne jemi të njohur me problematikën e tyre si dhe rrugët e tjera si “Kristina Koljaka”, “Omer Nishani”, “Anthim Konomi” rrugët gjysëm të asfaltuara si “Abedin Çiçi” dhe “Pavlo Pavli” janë pjesë e investimeve të ardhshme të buxhetit 2018.

**Z. Tefik Sadikaj** (Njësia Administrative Nr.3): Problem në zonën e Kodrës së Prifit janë ujrat e zeza, por një tjetër problem edhe më i rëndësishëm janë mungesa e çerdheve, kopshteve dhe shkollave në zonën e Kodrës së Prifit.

**Znj. Ergesta Ninga:** Është një problem mungesa që Z. Tefik nxorri në pah, por duke qënë se Kodra e Prifit është një zonë që ka marrë zhvillim dhe mbipopullim vitet e fundit, ndaj nuk ka asnjë prej këtyre institucioneve. Sigurisht që është në vëmendjen tonë plotësimi i kësaj nevoje ndaj komunitetit të kësaj zone.

**Z. Konstandin Dine:** (Njësia Administrative Nr.3): Doja t’ju falenderoja për gjithë punën që keni bërë dhe z. Veliaj për gjithë vëmendjen që na ka kushtuar, por doja të thoja që brenda mundësive të merren masa për ujrat e zeza dhe përmbytjet tek rruga e Kokonozëve, duhet një rikualifikim i kësaj rrugë.

**Z. Muhedin Çami:** (Njësia Administrative nr. 4) Mendoj që malorja tek Shkolla e Bashkuar, që është hapsira ndërmjet Njësisë Administrative 3 dhe Njësisë Administrative nr.4 dhe duhet të shtyhet muri i shkollës së Bashkuar dhe të zgjerohet dhe të shtrihet rruga.

**Z. Erindi Bejko:** Edhe gjërat e vogla në dukje kanë kosto dhe duhet të gjejmë instrumentin e duhur që buxhetin që kemi ta përdorim në mënyrë sa më efikase.

**Z. Ymer Bukaçi:** (Njësia Administrative nr. 4) Mendoj që referuar dhe kërkesave të banorëve tek rruga e Dibrës, pranë Komisarariatit të Policisë nr. 4 të shihet mundësia e vendosjes së një mbikalimi duke qënë se është një kalim i rrezikshëm për kalimtarët aty pranë.

**Z. Erindi Bejko:** Do ta shohim dhe vlerësojmë si mundësi për ti ardhur në ndihmë komunitetit.

**Z. Hasan Rama:** (Njësia Administrative nr. 4) Përse duhet që për të veshur pallatet me polisterol duhet të marrim leje ne Bashki?

**Z. Erindi Bejko:** duhet të zgjidhet administratori i pallatit dhe të përdoret fondi i komunitetit. Në këtë mënyrë dhe ju paguani më pak dhe nuk keni nevojë të merrni leje. Deri në korrik të vitit 2018 të gjithë pallatet do të kenë administratorë.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!

